



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KURBIN
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____.____.2025

Shtojca 12

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data. .12.2025

Drejtuar: Operatorit ekonomik “KEGLI-DURI” SHPK, me numër NIPTI **K94016202U**,
Adresa: Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Fushe Kruje , Lagjja Grumbullimit,
rruga e Laçit, pallat I ri, kati 1, zona kadastrale nr. 1664, me numer pasurie 3/426.

Tipi i Kontratës: Punë

Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-64794-10-14-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Asfaltim i rrugës së Tankeve Laç”.

Fondi limit: **9,997,864** (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 40 ditë.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 15.10.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Nr.61,
datë 20.10.2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

**Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë,
Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:**

1. Operatori ekonomik “NDERTUESI 2000” SHPK, me numër NIPTI **J96409033R**.
Vlera e ofertuar: **7,502,895** (shtatë milion e pesëqind e dy mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë **pa TVSH**.
2. Operatori ekonomik “KEGLI-DURI” SHPK, me numër NIPTI **K94016202U**.
Vlera e ofertuar: **7,798,353** (shtatë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e treqind e pesëdhjetë e tre) lekë **pa TVSH**.

3. Operatori ekonomik **“SHKELQIMI 07” SHPK**, me numër NIPTI **K68121808W**.
Vlera e ofertuar: 8,110,000 (tetë milion e njëqind e dhjetë mijë) lekë **pa TVSH**.
4. Operatori ekonomik **“BAMI HOLDING” SHPK**, me numër NIPTI **J94416206R**.
Vlera e ofertuar: 8,307,849.35 (tetë milion e treqind e shtatë mijë e tetëqind e dyzet e nëntë pikë tridhjetë e pesë) lekë **pa TVSH**.
5. Operatori ekonomik **“K.TURJA” SHPK**, me numër NIPTI **K81314014A**.
Vlera e ofertuar: 8,795,565 (tetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë **pa TVSH**.

Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik **“NDERTUESI 2000” SHPK**, me numër NIPTI **J96409033R**.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....., oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:**

KVO pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “NDERTUESI 2000” SHPK, dokumentacion i cili u protokollua në Bashkinë Kurbin me Nr.4720/11 Prot, datë 10.11.2025, konstatoi se operatori ekonomik **nuk plotëson kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.9 të DST (Për mjetet)**, si më poshtë:

Së pari: Operatori ekonomik “NDERTUESI 2000” SHPK, nuk ka paraqitur mjet Autobot Uji sipas kërkesave të përcaktuara në DST nga Autoriteti Kontraktor.

Për **Autobot Uji** OE ka paraqitur **mjetin me targë AA427BN** shoqëruar me: *Leje Qarkullimi, Çertifikatë Pronësie, Policë, Taksat Vjetore, Çertifikatë të Kontrollit Teknik, Çertifikatë për Transport, si dhe Faturë Tatimore Shitje Nr.265, datë 17.03.2009 (Depozitë Uji 5000L).*

Sqarojmë se ky mjet nuk është Autobot Uji sipas kërkesave të kërkuara nga AK, por është Kamion të cilës i kanë vënë një depozitë uji sipër. Theksojmë se referuar çertifikatës së pronësisë si dhe fotos së mjetit, nuk është Autobot Uji me dokumentacion, ndërsa AK ka kërkuar Autobot Uji, i cili nevojitet për punimet gjatë shtrimit të rrugës.

Së dyti: Operatori ekonomik “NDERTUESI 2000” SHPK, nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për mjetin Kamioncinë me targë AA296OL sipas kërkesave të përcaktuara në DST nga Autoriteti Kontraktor

Për **Kamioncinë** ka parqitur mjetin me targë **AA296OL** shoqëruar me: *Leje Qarkullimi, Çertifikatë Pronësie, Çertifikatë për Transport, Çertifikatë të Kontrollit Teknik, Policë, Foto mjeti.*

Sqarojmë se për mjetin me targë AA296OL, mungojnë Taksat Vjetore, nuk i ka paraqitur fare.

Së treti: Operatori ekonomik “NDERTUESI 2000” SHPK, nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për mjetin Eskavator me goma, sipas kërkesave të përcaktuara në DST nga Autoriteti Kontraktor.

Për **Eskavator me goma** operatori ekonomik ka paraqitur: *Kontratë Shitje nr.1093 Rep, datë 21.03.2010 & Foto mjeti.*

Sqarojmë se mungon dokumentacioni përkatës si: Leje Qarkullimi, Çertifikatë Pronësie, Policë, Taksat Vjetore, Çertifikatë të Kontrollit Teknik, pasi ky është mjet me goma dhe mjetet me goma duhet të kenë dokumentacion për të qarkulluar në rrugë.

Së katërti: Operatori ekonomik “NDERTUESI 2000” SHPK, nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për mjetin Kamion me vinç me targë AA498IL, sipas kërkesave të përcaktuara në DST nga Autoriteti Kontraktor.

Për **Kamion me vinç** ka parqitur mjetin me targë **AA498IL** shoqëruar me: *Kontratë Qiraje Nr.3735 Rep, Nr.1535 Kol, datë 24.10.2025, Çertifikatë Pronësie, Leje Qarkullimi, Çertifikatë të Kontrollit Teknik, Policë, Çertifikatë për Transport, Foto, Ekstrakte QKB.*

Sqarojmë se për mjetin me targë AA498IL, mungojnë Taksat Vjetore, nuk i ka paraqitur fare.

Për sa më sipër, KVO nuk mund të kualifikojë një operator ekonomik, i cili nuk plotëson/paraqet dokumentacionin sipas kërkesave që Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar në DST.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe të nenit 82, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik “NDERTUESI 2000” SHPK, **S’Kualifikohet.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“KEGLI-DURI” SHPK**, me adresë: Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Fushe Kruje , Lagjia Grumbullimit, rruga e Laçit, pallat I ri, kati 1, zona kadastrale nr. 1664, me numer pasurie 3/426, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **7,798,353** (shtatë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e treqind e pesëdhjetë e tre) lekë **pa TVSH**, është identifikuar si fitues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

Titullari i Autoritetit Kontraktor

Majlinda CARA